

VENDIM
Nr. 340, datë 21.12.2022

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395, SERIA F18, TË SHOQËRISË
“ENERGJI ASHTA” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 314, datë 06.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.12.2022 dhe 8.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 16.12.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për rinovimin licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16, “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1 (neni 16, germa “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, germa “b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, germa “c”) shtojca 1.I; të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezulton debitore e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Duke qene se licenca nr. 395, seria F18, e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, përfundon afatin e saj në datën 30.1.2023, vlerësohet që afati i rinovimit të saj të fillojë nga data 31.1.2023.

- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k. rezulton se dokumentacioni është i plotësuar tërësisht si vijon:

- Neni 16, pika 1, germa “a”, “b”, “c”: plotësuar;

- Neni 16, pika 7: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 395, seria F18, të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 26, datë 30.1.2018, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 31.1.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti